



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS

NOTER ILA A. PISTOLJA  
ADRESA AQIF PASHA/NR.4, 28  
NENTORI, NR.9, NR.1, NR.31/1  
TEL: 694291913

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(AKSIONE)

Nr. repertori: 2728

Nr. koleksioni: 878

Elbasan më 01/12/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2021010720078696091



A2021010720078696091

## KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Sot, më datë 01.12.2021, para meje Notere ILA A. PISTOLJA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Elbasan, AQIF PASHA/NR.4, 28 NENTORI, NR.9, NR.1, NR.31/1, u paraqit personalisht:

**DHURUES:** Gentian Guni, atësia Artur, amësia Mimoza, shtetas Shqiptar, lindur në Elbasan dhe banues në Elbasan, me adresë Rajoni 5, Lagja Haxhias, Rruga Besim Levonja; Nd. Nr.2; Elbasan; Elbasan; 3005; Elbasan, lindur më 08/11/1994, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031466909 dhe nr. personal J41108060I, (Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Dhuruesi**")

**PRANUES I DHURIMIT:** Enisa Guni, atësia Artur, amësia Mimoza, shtetase Shqiptare, lindur në Elbasan dhe banuese në Elbasan, me adresë Rajoni 5, Lagja Haxhias, Rruga Besim Levonja; Nd. Nr.2; Elbasan; Elbasan; 3005; Elbasan, lindur më 16/02/1996, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032474099 dhe nr. personal J65216066R, (Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Përfituesi**" i **dhurimit**")

### Rrethanat e hartimit të aktit noterial:

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. Unë noteri/ja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

#### Neni 1

Objekti i Kontrates:

Dhurim kuotash të Shoqërisë Tregtare "**ALBANIAN SPORT & TOURISM**" SH.P.K. Palet si më lart, me vullnet të lirë dhe të plotë kanë rënë dakord që bazuar në Vendimin e Asamblese së Përgjithshme të Aksionareve të Shoqërisë "**ALBANIAN SPORT & TOURISM**" SH.P.K, janë dakort sa vijon: Dhuruesi, **njekohesisht ortak I vetem Z. GENTIAN GUNI**, i Shoqërisë "**ALBANIAN SPORT & TOURISM**" SH.P.K regjistruar si sh.p.k pranë QKB-se, me datë 08.11.2018 me NIPT: L83508203B duke zotëruar pranë kësaj shoqërie 1 kuotë në masën 100% të barasvlefshme me kontributin në para 100.000,<sup>00</sup> Leke.

**GENTIAN GUNI** është dakort sot t'i dhurojë pa kundërshtim 50% e kuotave/aksioneve që ai zotëron në Shoqërinë "**ALBANIAN SPORT & TOURISM**" SH.P.K **zj. ENISA GUNI** (sipas vendimit të asamblese).

#### Neni 2

### Kalimi i pronësisë dhe mbyllja e transaksionit

**2.1** Kalimi i titullit të pronësisë mbi Aksionet objekt i kësaj Kontrate, do të kalojë nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit, dhe ky i fundit do të bëhet zotëruar me të drejta të plota i 1 Aksioneve, që përfaqësojnë 50 % të kapitalit të Shoqërisë, në datën e depozitimit të kësaj Kontrate dhe regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

#### Neni 3





A2021010720078696091

## Deklarime dhe Garanci

3.1 Dhuruesi nëpërmjet kësaj Kontrate deklarohet dhe garanton Pranuesin e Dhurimit se:

- Shoqëria është SHPK i regjistruar rregullisht në Regjistrin Tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe ushtron aktivitetet tregtar sipas parashikimeve të ligjit në fuqi dhe sipas dispozitave të statutit;-
- Dhuruesi i zotëron Aksionet të lira nga çdo peng, barrë siguroese, hipotekë, pengesë, pretendime të tretëve, kufizime, të drejtë parablerje si dhe çdo masë tjetër sigurie apo ligjore;
- Dhuruesi zotëron Aksionet e tij për llogari dhe në emrin e vet, dhe nuk ekziston asnjë "ortak i fshehtë" ose detyrim përsa i përket ndarjes së fitimit;
- Shoqëria nuk është në proces falimentimi ose likuidimi;
- Shoqëria ka paguar të gjitha detyrimet fiskale në përputhje me ligjin në fuqi dhe parimeve të kontabilitetit.
- 3.2 Pranuesi i Dhurimit me anë të kësaj Kontrate deklarohet dhe garanton Dhuruesin se

- Pranuesi i Dhurimit zotëron të gjithë të drejtat ligjore për nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe se këto të drejta nuk janë objekt, apo në kundërshtim, apo nuk përbëjnë shkelje të ndonjë gjykimi, urdhri, vendimi gjyqësor, dekreti ose vendimi të çdo gjykate apo autoriteti shtetëror, subjekt i të cilit është Pranuesi i Dhurimit, si dhe ndonjë marrëveshje, licence ose angazhimi në të cilin Pranuesi i Dhurimit është palë që do të cënonte aftësinë e tij për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë.

### Neni 4

#### Tërësia e kontratës dhe ndryshimi i kushteve

4.1 Nëse, në çdo kohë, ndonjë prej dispozitave të kësaj marrëveshje është ose bëhet e pavlefshme, e pasaktë apo e pazbatueshme në bazë të ligjit të aplikueshëm, pavlefshmëria, pasaktësia apo pazbatueshmëria e kësaj dispozite nuk do të çënojë apo shfuqizojë dispozitat e tjera të kësaj Kontrate. Çdo dispozitë e pavlefshme, e pasaktë apo e pazbatueshme do të zëvendësohet me një dispozitë tjetër të vlefshme, efektive dhe të zbatueshme që pasqyron efektet ligjore të së parës.

4.2 Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve lidhur me parashikimet në të. Titujt apo emërtimet e shprehura në këtë Kontratë janë përfshirë vetëm për lehtësi referimi në tekst dhe në këtë kontratë në tërësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kushteve dhe dispozitave të kësaj Kontrate.-

4.3 Çdo parashikim i kësaj Kontrate mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga Palët e kësaj Kontrate, ndryshimet e kryera verbalisht nuk janë të vlefshme.

### Neni 5

#### Ndryshimi i Shoqërisë pas nënshkrimit të kësaj Kontrate.

5.1 Administratori i Shoqërisë në përputhje me Vendimin E Asamblese Se Përgjithshme të Aksionareve mbetet Z. GENTIAN GUNI, sipas afatit ekzistues.

5.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate Z. GENTIAN GUNI mbetet zotëruar i 1 te kuotave/aksionëve (njekohesisht 1 pjesëve) të shoqërisë "ALBANIAN SPORT & TOURISM" shpk, dhe Zj. ENISA GUNI bëhet zotëruar e 1 te kuotave/aksionëve (njekohesisht 1 pjesëve) të shoqërisë "ALBANIAN SPORT & TOURISM" SH.P.K, që përfaqësojnë 50% të kapitullit ose në para: 50,000 lekë.

### Neni 6

#### Juridiksioni dhe mosmarrëveshjet

6.1 Kjo Kontratë bazohet në, dhe zbatohet sipas ligjit shqiptar, dhe interpretimi, vlefshmëria dhe përmbushja e saj realizohet dhe zbatohet në përputhje me ligjin shqiptar në fuqi. Çdo çështje, detyrim apo kusht që nuk parashikohet në këtë Kontratë rregullohet nga ligji shqiptar dhe dispozita të tjera ligjore të aplikueshme.-



A2021010720078696091

6.2 Çdo mosmarrëveshje apo kundërshtim si rrjedhojë apo lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj kontrate që nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore ndërmjet Palëve, do të parashtrohet për zgjidhje gjykatës kompetente në Shqipëri nëse palët nuk bien dakord me shkrim. Ky akt hartohet në 4 (katër) fletë dhe printohet në 4 (kopje) kopje me të njëjtën vlerë ligjore, nga të cilat 3 kopje i jepen të Palëve dhe një kopje për arkivën e zyrës sime noteriale.

Unë, noterja deklaroj se mora pëlqimin e palës për përdorimin e të dhënave personale. Këto të dhëna janë konfidenciale dhe u përdorën vetëm për krijimin dhe redaktimin e këtij akti, në zbatim të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Unë, Noterja pasi ia lexova tekstin e kësaj kontrate me zë të qartë dhe të kuptueshëm palëve dhe pasi ata deklaruan me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, se e kuptuan dhe e gjejnë përmbajtjen e kontratës në përputhje të plotë me thëniet e tyre, e nënshkruan rregullisht në praninë time, dhe unë Noterja vërtetoj këtë kontratë sipas ligjit.

Kontrata e kalimit të të drejtave, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Bashkëlidhur gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

#### Baza Ligjore

- Neni 761 e vijues të Kodit Civil
- Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar
- Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"

#### DHURUES

GENTIAN GUNI

Gentian Guni

#### PRANUES I DHURIMIT

ENISA GUNI

Enisa Guni

NOTER

ILA A. PISTOLJA